



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 121 Prot.

Tiranë, më 18 / 01 / 2021

V E N D I M

Nr. 9, Datë 18 / 01 / 2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 121 Regj, datë 20.10.2020, e G. D¹, kundër Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, me pretendim diskriminimin për shkak të “gjendjes ekonomike”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), është shprehur se, në vitin 2013 ka aplikuar pranë ish-Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ish-Aluizni-t), sot Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DV ASHK) Elbasan, për legalizimin e banesës së tij. Me datë 10.07.2013 ankuesi ka aplikuar për legalizimin e banesës dhe në vijim janë kryer procedurat përkatëse nga punonjësit e këtij Institucioni. Ankuesi pretendon se nga momenti i aplikimit dhe deri aktualisht nuk ka marrë asnjë informacion se në çfarë faze ndodhet procesi i legalizimit të banesës së tij.

Me datë 01.10.2020 ankuesi i është drejtuar DV ASHK Elbasan me kërkesë për informacion, lidhur me të drejtën për tu informuar se në çfarë faze ndodhej procesi i legalizimit të banesës së tij.

¹ Subjekti ankues), në ankesën e sjellë pranë KMD, është mbështetur nga Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome (LRER).

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Nëpërmjet shkresës me nr. 6595/1 prot., datë 09.10.2020, DV ASHK Elbasan i është përgjigjur ankuesit duke e informuar se: *“Në përputhje me përcaktimet ligjore të nenit 63, të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën” dhe në përputhje me VKM nr. 389, datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, duhet të aplikojë në portalin e-Albania dhe t’i nënshtrohet tarifave të përcaktuara”*.

Referuar kësaj VKM-je, në Aneksin 1 të saj tek “Lista e shërbimeve të ofruara nga ASHK” në numrin rendor 63 “Informacioni zyrtar i pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë)”, është përcaktuar se, ka tarifën 2000 lekë.

Ankuesi, i ndodhur në situatë ekonomike të vështirë, (sipas dokumentacionit të ardhurat e tij familjare burojnë vetëm nga ndihma ekonomike në shumën prej 7048 lekësh), e ka të pamundur të paguajë shumën prej 2000 lekësh. Ai pretendon se ndihet i diskriminuar, pasi për shkak të pamundësisë ekonomike, atij i mohohet aksesimi për marrjen e informacionit lidhur me fazën në të cilën ndodhet procesi i legalizimit të banesës së tij, duke u shprehur se ligji nr. 111/2018 dhe VKM-ja sipërcituar duhet të parashikojnë lehtësira dhe përjashtim nga pagimi i kësaj tarife për personat në pamundësi ekonomike.

Në përfundim të ankesës së tij, subjekti ankues, ka kërkuar: *“Konstatim diskriminimi për shkak të gjendjes ekonomike nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën” dhe nga ana e Këshillit të Mnistrave, nëpërmjet VKM nr. 389, datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale”*.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

³Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1425/1 prot., datë 03.11.2019 nga ana e KMD i është kërkuar informacion Këshillit të Ministrave (KM), Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe Drejtorisë Vendore të ASHK Elbasan, lidhur me pretendimin e ankuesit.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 7228/1 prot, datë 16.11.2019, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DV ASHK) Elbasan ka dërguar parashtrimet e veta duke cituar se:

“Në bazë të verifikimeve të kryera në bazën e të dhënave digjitale të vetëdeklarimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK Tiranë dhe verifikimit të kryer pranë Institucionit tonë, rezulton se shtetasi G. D është aplikues në procesin e legalizimeve të ndërtimeve informale, me Formular Vetëdeklarimi me nr. 1027prot., datë 10.07.2013 dhe me nr. 11636 prot., datë 19.12.2014, për objektin informal të ndodhur në lagjen “5 Maji”, Bashkia Elbasan. Gjithashtu, ju informojmë se për objektin informal në fjalë është bërë evidentimi i tij në terren dhe nga ana e DV ASHK Elbasan u morën masa që dosja të dalë në shqyrtim administrativ”.

DV ASHK Elbasan ka nënvizuar faktin se, vijimi dhe përfundimi i procedurave të legalizimit, është një proces i cili për shkak të numrit të madh të aplikimeve, kompleksitetit që mbart është i shtrirë në kohë dhe se kanë prioritet në trajtim, vetëdeklarimet për legalizim gjatë viteve 2005-2006, duke respektuar të drejtën e subjekteve që kanë deklaruar të parët, të marrin shërbimin e kërkuar.

DV ASHK Elbasan shprehet se bazuar në sa më sipër, do të kryejë procedurat e legalizimit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe se do të informojë në vijimsi mbi ecurinë administrative të kësaj çështjeje.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë të pretenduar nga ankuesi.

- a) **Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim nëpërmjet ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë.**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë⁴, në nenin 131, pika 1 gërmat a dhe c ka sanksionuar se: “1. Gjykata Kushtetuese vendos për: a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122 dhe c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare”.

Neni 134 i Kushtetutës ka përcaktuar qartazi subjektet të cilat legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

“Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të:

a) Presidentit të Republikës;

b) Kryeministrit;

c) jo më pak se një të pestës së deputetëve;

ç) Avokatit të Popullit;

d) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;

dh) çdo gjykatë, sipas nenit 145, pika 2, të kësaj Kushtetute;

e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta;

ë) Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

f) organeve të qeverisjes vendore;

g) organeve të bashkësive fetare;

gj) partive politike;

h) organizatave;

i) individëve”.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se, çdo individ sikurse dhe ankuesi në rastin konkret, legjitimohet për t’iu drejtuar KMD-së duke pretenduar për diskriminim të shkaktuar nga dispozita të caktuara ligjore apo akte normative.

Nëse Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës së G. D, do të konstatonte se ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” si dhe VKM-së nr. 389, datë 13.05.2020 përmbajnë elementë të tillë diskriminues, të cilët çënojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, do të vinte në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave përkatëse të ligjit dhe VKM-së së mësipërme.

Për rrjedhojë, Komisioneri për efekt të trajtimit të ankesës së subjektit G. D, ka analizuar *prima facie*, pretendimin e tij për diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, në lidhje me parashikimet e këtij ligji, për të drejtën e personave fizikë për garantimin e aksesit mbi ekstaktet e regjistrit kadastral, si dhe për marrjen e infomacionit për pasuritë e tyre të paluajtshme.

Në këtë këndvështrim, Komisioneri konstaton se, ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” ka si objekt të tij, rregullimin e shërbimit publik lidhur me regjistrimin e pasurive të paluajtshme, organizimin

⁴ Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016

e institucionit përgjegjës për këtë shërbim dhe mënyrën e administrimit të kadastrës, si regjistër publik i pasurive të paluajtshme.

Në nenin 2 “Fusha e veprimit” parashikohet se:

“ Në këtë ligj përcaktohen rregulla për:

- a) organizimin e regjistrit kadastral të shtetit;
- b) regjistrimin e pronave të paluajtshme private, shtetërore dhe publike, të të drejtave reale mbi to;
- c) përmirësimin/përditësimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme;
- ç) krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”.

Neni 4, në pikat 1 dhe 3, të këtij ligji ka parashikuar se: “1. Subjekte, në kuptim të këtij ligji, konsiderohen pronarët, titullarët e të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme, personat fizikë ose juridikë, që kanë interes të ligjshëm mbi pasuritë. 3. Pronarëve dhe titullarëve të të drejtave reale mbi pasuritë u ofrohet shërbimi kadastral, duke u mjaftuar me identifikimin e tyre përpara zyrave dhe drejtorive vendore të ASHK-së. Për titujt e regjistruar, institucioni verifikon vetë lidhjen e pronarit me pronën e tij, pa detyruar pronarin të sjellë dokumnetacion që i lëshon vetë drejtoria kadastrale”.

Sa më sipër, konstatohet se, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, ankuesi nuk përfshihet në subjektet, në kuptim të këtij ligji, pasi ai ligjërisht, ende nuk konsiderohet pronar apo titullar i të drejtave reale mbi pasurinë e paluajtshme, për shkak se pasurinë në fjalë (objektin, banesë informale) e ka në proces legalizimi.

Nga ana tjetër, ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar si objekt të tij, përcaktimin e procedurave dhe organin shtetëror përgjegjës për përfundimin e proceseve kalimtare administrativo-ligjore, të regjistrimit të titujve të pronësisë për pasuritë e paluajtshme në pronësi shtetërore dhe private në Republikën e Shqipërisë, si dhe të inventarizimit, transferimit, trajtimit dhe regjistrimit përfundimtar të tyre.

Në nenin 2, pika 1/c), ka përcaktuar se, qëllimi i këtij ligji është:

“ 1. Krijimi i bazës ligjore të thjeshtuar e të harmonizuar për përfundimin e proceseve kalimtare administrativo-ligjore të trajtimit të pronës së paluajtshme të shtetit dhe pronës private, duke përcaktuar normat për:

c) legalizimin dhe regjistrimin në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, ndërtimeve pa leje, objekteve dhe trojeve funksionale, kur mungojnë aktet e fitimit të pronësisë, si dhe të oborreve në përdorim”.

Pika 9, e nenit 4, të këtij ligji, ka sanksionuar se: “Legalizim”, në kuptim të këtij ligji, është procesi administrativo-ligjor që kryen Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për plotësimin dhe regjistrimin e titujve të pronësisë për ndërtimet pa leje”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues i nënshtrohet përcaktimeve dhe rregullimeve të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Duke qenë se G. D është aplikues në procesin e legalizimeve të ndërtimeve informale, përgjigja e DV ASHK Elbasan, duke ju referuar ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën” dhe aktit normativ përkatës, për rastin konkret, është e gabuar.

Rasti i ankuesit ka të bëjë në lidhje me ecurinë e procesit të legalizimit të objektit të tij (i cili akoma është në proces legalizimi, e për pasojë as i regjistruar në Kadastër) dhe për rrjedhojë, si referimi i DV ASHK Elbasan, ashtu edhe ankesa e G. D tek dispozitat e ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën” dhe VKM-së përkatëse, janë të pabazuara.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk është diskriminuar nga ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

b) Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim nga Këshilli i Ministrave.

Në zbatim të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, Këshilli i Ministrave, ka miratuar Vendimin nr. 389, datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”.

Ky vendim përcakton shërbimet publike kadastrale që ofron Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në zbatim të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Lidhur me pretendimet e subjektit ankues për diskriminimin e tij nëpërmjet VKM nr. 389, datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, sa i takon detyrimit për të paguar shumën prej 2000 lekësh për marrjen e informacionit nga DV ASHK Elbasan, Komisioneri vlerëson se, ankuesi nuk përfshihet tek subjektet që janë objekt i kësaj VKM-je, për rrjedhojë këto pretendime nuk lidhen me zbatimin e këtij akti nënligjor.

Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk është diskriminuar për shkak të parashikimeve (apo mosparashikimeve) të VKM-së nr. 389, datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”.

c) Lidhur me trajtimin e kërkesës së ankuesit nga DV ASHK Elbasan.

Megjithëse subjekti e ka orientuar ankesën e tij ndaj akteve të Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, Komisioneri, për arsyet e cilësuar më sipër, vëren se subjekti përgjegjës për trajtimin e kërkesës për informim të ankuesit është DV ASHK Elbasan. Në këtë kontekst, është analizuar sjellja institucionale e DV ASHK Elbasan, në raport me të drejtën e ankuesit për t’u informuar dhe detyrimin institucional për t’i ofruar atij shërbimin përkatës, sipas parashikimeve ligjore.

Bazuar në kronologjinë e fakteve dhe dokumentacionin respektiv, Komisioneri vëren se,

Rezulton e provuar se subjekti ankues është aplikues në procesin e legalizimeve të ndërtimeve informale, me Formular Vetëdeklarimi me nr. 1027 prot., datë 10.07.2013 dhe me nr. 11636 prot., datë 19.12.2014, për objektin informal të ndodhur në lagjen “5 Maji”, Bashkia Elbasan.

Nëpërmjet kërkesës së datës 01.10.2020 ankuesi i është drejtuar DV ASHK Elbasan, lidhur me të drejtën për t’u informuar për ecurinë e procesit të legalizimit të banesës së tij.

Nëpërmjet shkresës me nr. 6595/1 prot., datë 09.10.2020, DV ASHK Elbasan i është përgjigjur se: *“Në përputhje me përcaktimet ligjore të nenit 63, të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën” dhe në përputhje me VKM nr. 389, datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, duhet të aplikojë në portalin e-Albania dhe t’i nënshtrohet tarifave të përcaktuara”.*

Aneksi 1, bashkëlidhur kësaj VKM-je ka përcaktuar në mënyrë të detajuar listën e shërbimeve të ofruara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, si dhe tarifatat përkatëse për secilin shërbim. Kështu, për llojin e shërbimit kadastral, të përcaktuar në numrin rendor 63, përcaktohet si më poshtë:

Nr. rendor	Lloji i shërbimit	Tarifa (Lekë)
63	Informacion zyrtar i pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë)	2000

Sa më sipër, subjektit ankues i është kërkuar nga DV ASHK Elbasan të kryejë pagesën prej 2000 lekësh për të marrë informacionin e kërkuar.

Ankuesi duke qenë në pamundësi financiare për realizimin e pagesës së kërkuar nga DV ASHK Elbasan, ka paraqitur ankesë para KMD, duke pretenduar dhe diskriminim e tij, pikërisht nga parashikimet e këtij akti nënligjor.

Bazuar në analizimin e ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën” dhe VKM nr. 389, datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, Komisioneri ka konstatuar se, ankuesi nuk bën pjesë tek subjektet në kuptim të këtij ligji dhe aktit të tij nënligjor, pasi pasurinë në fjalë (objektin banesë) e ka në proces legalizimi. Tarifatat e përcaktuara në VKM nr. 389, datë 13.05.2020, kanë të bëjnë me informacione, veprime, etj, për prona që figurojnë të regjistruara në regjistrin kadastral.

Në këtë fazë, ankuesi është subjekt që i nënshtrohet përcaktimeve dhe rregullimeve të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Bazuar në sa më sipër, DV ASHK Elbasan ka keqinterpretuar e keqzbatuar ligjin nr. 111/2018, si dhe VKM-në përkatëse për tarifatat e shërbimeve kadastrale, pasi informacioni i kërkuar nga ankuesi nuk përfshihet në shërbime kadastrale për të cilat duhet paguar ndonjë tarifë.

Për rrjedhojë edhe kërkesa e këtij institucioni për realizimin e pagesës konform këtij parashikimi është e gabuar.

Në përgjigje të kërkesës së KMD-së, me shkresën nr. 7228/1 prot, datë 16.11.2019, DV ASHK Elbasan, ka informuar Komisionerin dhe ankuesin, se:

“Shtetasi G. D është aplikues në procesin e legalizimeve të ndërtimeve informale, me Formular Vetëdeklarimi me nr. 1027prot., datë 10.07.2013 dhe me nr. 11636 prot., datë 19.12.2014, për objektin informal të ndodhur në lagjen “5 Maji”, Bashkia Elbasan. Gjithashtu, ju informojmë se për objektin informal në fjalë është bërë evidentimi i tij në terren dhe nga ana e DV ASHK Elbasan u morën masa që dosja të dalë në shqyrtim administrativ.

Vijimi dhe përfundimi i procedurave të legalizimit, është një proces i cili për shkak të numrit të madh të aplikimeve dhe kompleksitetit që mbart është i shtrirë në kohë. Në këtë aspekt, Drejtoritë Vendorë të ASHK kanë prioritet në trajtim, vetëdeklarimet për legalizim gjatë viteve 2005-2006. Është e drejta e subjekteve që kanë deklaruar të parët, të marrin shërbimin e kërkuar.

DV ASHK Elbasan do të kryejë procedurat e legalizimit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe se do të informojë në vijimsi mbi ecurinë administrative të kësaj çështjeje”.

Bazuar në sa më sipër, rezulton se, DV ASHK Elbasan ka përmbushur kërkesën e subjektit ankues lidhur me marrjen e informacionit për ecurinë e procesit të legalizimit të pronës së tij, pa e kushtëzuar këtë me pagimin e ndonjë tarife.

Prona e ankuesit është me status pronë informale dhe po trajtohet sipas ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj nuk ka parashikuar asnjë kufizim/pagesë tarife lidhur me marrjen e informacionit për sa ka kërkuar ankuesi.

Referuar rastit konkret, bazuar në nenin 23, pika 1 dhe 2 e Kushtetutës, Komisioneri thekson se, e drejta e informimit është një e drejtë kushtetuese e si e tillë është e garantuar dhe se kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetore.

Komisioneri sjell në vëmendje se, informacioni i kërkuar nga subjekti ankues apo çdo subjekt tjetër i ndodhur në kushte të njëjta, është një informacion i cili i duhet dhënë personit, bazuar në parashikimet ligjore të nenit 19, të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar, i cili ka sanksionuar se: *“Procedura administrative është pa pagesë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe”*, si dhe parashikimet ligjore të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, objekti i të cilit rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike.

Pika 3 e nenit 3, të këtij ligji, sanksionon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit”.*

Po ashtu, pika 2, e nenit 2, të tij, përcakton se: *“Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.*

Bazuar në sa më sipër cituar, Komisioneri vlerëson se, kërkesa e ankuesit lidhur me marrjen e informacionit të kërkuar duhet konsideruar e përmbushur, pasi gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës së tij pranë KMD-së⁵ DV ASHK Elbasan ka dhënë informacionin e kërkuar.

Por, Komisioneri sjell në vëmendje të këtij institucioni se, raste të tilla, që mohojnë të drejtën e aksesit dhe informimit nuk duhet të përsëriten.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 19, të Kodit të Procedurës Administrative, ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nenin 3, pika 1 dhe 3, nenin 7, pika 1, nenin 11, nenin 32, pika 1, germa a) dhe, nenin 33, pikat 9 dhe 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Përmbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të “gjendjes ekonomike”, të subjektit ankues dhe të gjithë kategorisë të aplikantëve të ndodhur në të njëtat kushte apo kushte të ngjashme me të, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe DV ASHK Elbasan.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Gjendja ekonomike
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim

⁵ Ankuesi ka marrë dijani për shkresën me nr. 7228/1 prot, datë 16.11.2019 të DV ASHK Elbasan.